



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 218 Prot.

Tiranë, më 14/02 /2022

VENDIM

Nr. 51, datë 14 .02.2022

PËR

**REALIZIMIN E SHORTIT PËR KANDIDATËT PËR ANËTAR TË SENATIT
AKADEMIK, PËRFAQËSUES TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE
TEKNIKE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në pikën 12, të nenit 4 e vijues të Rregullores së Zgjedhjeve, miratuar nga Senati Akadcmik i UMT-së me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", të Vendimit të KZF FSHMT nr. 16, datë 31.07.2020 "Për shpalljen e rezultateve të votimit për Senat Akademik në FSHMT", në Vendimin e KIZ nr. 17, datë 07.07.2020 "Për miratimin e listës së kandidatëve për anëtarë të Senatit Akademik të Universiteti të Mjekësisë, Tiranë", si dhe shkresës së Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë me nr. 178/2 prot., datë 10.02.2022 "Mbi kryerjen e shortit ...", Komisioni Institucional Zgjedhor,

VENDOSI:

1. Të zhvillojë shortin për kandidatët për anëtar të Senatit Akadcmik në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, përfaqësues të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike të UMT, të cilët kanë numër të barabartë votash, konkretisht Prof. Arben Pilaca dhe Prof. Asc. Irena Kola.
2. Shorti do të kryhet nga KIZ, me gogla në prani të palëve (mosprezenca e palëve nuk do të përbëjë shkak për mos kryerjen e shortit).
3. Shorti do të kryhet ditën e martë më datë 15.02.2022, ora 14:00 në ambjentet e KIZ.
4. Të ftojë Prof. Arben Pilaca dhe Prof. Asc. Irena Kola të marrë pjesë në procedurën e shortit që do të kryejë Komisioni Institucional Zgjedhor.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në mjediset e UMT-së, në faqen zyrtare të institucionit.

**KRYETARI
SILVANA BALA**

